



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 13 Shtator 2022

Nr: 190

VENDIM

PËR

SHQYRTIMIN E REZULTATIT TË VERIFIKIMIT TË PROKURORIT TË PËRGJITHSHËM PËR SUBJEKTIN VETËDEKLARUES Z. ARTAN (ERGI) NAZMI BITRI, KANDIDAT PËR DEPUTET I PROPOZUAR NGA PARTIA SOCIALISTE E SHQIPËRISË, QARKU DURRËS NË ZBATIM TË LIGJIT NR. 138/2015 “PËR GARANTIMIN E INTEGRITETIT TË PERSONAVE QË ZGJIDHEN, EMËROHEN OSE USHTROJNË FUNKSIONE PUBLIKE”

Sot më datë 13.09.2022, unë, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, në seancë publike shqyrtova çështjen me:

- Objekt: Shqyrtimi i rezultatit të verifikimit të Prokurorit të Përgjithshëm për subjektin vetëdeklarues z. Artan (Ergi) Nazmi Bitri, kandidat për deputet i propozuar nga Partia Socialiste e Shqipërisë, qarku Durrës, në zbatim të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”.
- Palë të interesuara: Z. Artan (Ergi) Nazmi Bitri, kandidat për deputet i listës shumëmemërore të propozuar nga Partia Socialiste e Shqipërisë, për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 Prill 2021.
- Baza ligjore: Nenet 19, pikat 1, shkronja “n” e 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, ligji nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, pika 3, shkronja “ç”, të Kreut III, të vendimit nr. 17/2016, të Kuvendit, “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, neni 190 i Kodit Penal.

Në përfundim të shqyrtimit administrativ,

VËREJ:

I.



Data: 13 Shtator 2022
Nr. 190

Për shqyrtimin e rezultatit të verifikimit të Prokurorit të Përgjithshëm për subjektin vetëdeklarues z. Artan (Ergi) Nazmi Bitri, kandidat për deputet i propozuar nga Partia Socialiste e Shqipërisë, qarku Durrës, në zbatim të ligjit nr. 138/2015

Në zbatim të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike” Komisioni Qendror i Zgjedhjeve është organi kompetent për administrimin, verifikimin, zbatimin e ndalimeve për zgjedhjen dhe emërimin për funksionet publike si dhe përpunimin për formularin e vetëdeklarimit për disa subjekte ndër të cilat është edhe “Kandidati për deputet”.

Z. Artan (Ergi) Nazmi Bitri, kandidat për deputet i listës shumëmemërore të propozuar nga Partia Socialiste e Shqipërisë, në zgjedhjet për Kuvend të datës 25 Prill 2021, ka depozituar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve formularin e vetëdeklarimit me numër unik 1670.

Përpara miratimit të listave të kandidatëve për deputetë për subjektin zgjedhor Partia Socialiste e Shqipërisë, në bazë të kompetencave të veta, KQZ bëri verifikimin “prima facie” dhe pasi konstatoi se kandidati nuk është në kushtet e ndalimit, ndërmori hapat e mëposhtme:

- a. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, me shkresën nr. 1988 Prot., datë 12.03.2021, ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes gjyqësore, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, e cila nga ana e saj me shkresën nr. 2689/1 Prot., datë 12.03.2021, informon Komisionin Qendror të Zgjedhjeve se kandidati për deputet, z. Artan (Ergi) Nazmi Bitri, nuk ka të regjistruar dënime penale të formës së prerë në sistem, pra nuk është i dënuar.
- b. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, me shkresën nr. 1987 Prot., datë 12.03.2021, ka kërkuar informacion pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile, e cila nga ana e saj me shkresën nr.1066/1 Prot., datë 08.04.2021, informon Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, se kandidati për deputet z. Artan (Ergi) Nazmi Bitri, rezulton të ketë ndryshime në përbërësit e gjendjes civile, më datë 03.07.2006, me procesverbal nr.111, ka ndryshim emri nga “Artan” në “Ergi”, dhe më datë 05.05.2008 me procesverbal nr.58 ka ndryshim emri nga ”Ergi” në “Artan”.
- c. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve me vendimin nr. 408, datë 23.06.2021 miratoi shpërndarjen e mandateve midis subjekteve zgjedhore, përcaktimin e kandidatëve fitues si dhe rirenditjen e kandidatëve, në zonën zgjedhore qarku Durrës për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25.04.2021. Në bazë të rirenditjes së kandidatëve të cilët nuk kanë përfituar mandat në bazë të numrit të votave, kandidati për deputet z. Artan (Ergi) Nazmi Bitri rezulton nr. 14 (katërmbëdhjetë) rendor në listë.

II.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në zbatim të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, verifikoi të dhënat në formularin e vetëdeklarimit të kandidatit për deputet z. Artan (Ergi) Nazmi Bitri.

Nga verifikimi i të dhënave në formularin e vetëdeklarimit të z. Artan (Ergi), Nazmi Bitri, rezulton se ka deklaruar:

- Në rubrikën I. “TË DHËNA PERSONALE”, PIKA B, “Gjenealitete të mëparshme” të formularit të vetëdeklarimit, subjekti vetëdeklarues ka deklaruar gjenealitetet e tij dhe është shprehur se, ka ndryshuar emrin nga “Ergi” në “Artan”.
- Në rubrikën III. “TË DHËNA MBI GJENDJEN GJYQËSORE TË PERSONIT”, të Formularit të Vetëdeklarimit.

Pyetjes 7, “A është marrë për ju ndonjëherë masa e dëbimit nga një shtet i huaj?”, subjekti vetëdeklarues është përgjigjur “Po “duke deklaruar se: “Është marrë masë dëbimi nga Napoli, Itali, për mungesë dokumentacioni, për periudhën 2002-2012, për të cilën është vendosur ekspulsion”.

Nga konstatimet e mësipërme dhe bazuar në nenin 8, pika 1, të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e Integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, Kreu V, pika 2, shkronja “c”, të Vendimit të Kuvendit, nr. 17/2016 “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me shkresën nr. 2542 Prot., datë 23.03.2021, vendosi t’ia kalojë rastin për verifikim të thelluar Prokurorisë së Përgjithshme, si institucioni kompetent që kryen verifikimin e plotë të deklarimeve të bëra.

Me shkresën nr. 527/59 Prot., datë 22.06.2022, Drejtoria e Koordinimit Institucional, Sektori i Dekriminalizimit pranë Prokurorisë së Përgjithshme, ka dërguar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, vendimin “Për miratimin e rezultatit të verifikimit për subjektin z. Artan (Ergi) Nazmi Bitri”.

Prokuroria e Përgjithshme, pas kryerjes së gjithë verifikimeve përkatëse, i konsideron këto të fundit të plota dhe të bazuara në nenin 8, pikat 1 dhe 2, të lidhura me nenin 5 të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike” si dhe në përcaktimet e pikës 3 shkronja “ç”, Kreu III dhe pikave 10, 11, 12 e 13 të Vendimit të Kuvendit nr. 17/2016, ka miratuar rezultatit të verifikimit të subjektit vetëdeklarues z. Artan (Ergi) Nazmi Bitri, sipas të cilit në dispozitivin e vendimit konstatohet si më poshtë:

1. Rezultoi të ketë përdorur gjenealitete të tjera (alias), në shtetin Italian që janë Artan Dokuzi dhe Hasan Berisha, përveç atyre të deklaruara në formular apo të ndryshme nga ato të deklaruara në formular;
2. Nuk rezultoi i dënuar me vendim të formës së prerë, për kryerjen e ndonjë veprë penale, nga autoritetet gjyqësore shqiptare apo të huaja;
3. Nuk rezultoi i dënuar me vendim gjyqësor jopërfundimtar nga ndonjë autoritet gjyqësor shqiptar ose i huaj, për një çështje penale të pazgjidhur me vendim gjyqësor të formës së prerë;
4. Rezultoi që me gjenealitetet Artan Dokuzi, të ketë qënë i ndaluar/arrestuar për emigracion klandestin nga Njësia Operative dhe Radiomobile e Karabinierëve të “Compania di Sessa Aurunca (CE)” në datën 09 mars 2005. Liruar në datën 11 mars 2005 nga burgu SMCV, i pajisur me Urdhrin e lëshuar nga Kuestori i Caserta-s për të lënë territorin kombëtar.

III.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, në përfundim të shqyrtimit të dokumentacionit dhe rezultatit të verifikimit të thelluar, të Prokurorit të Përgjithshëm konstaton se:

- Ligji nr. 138/2015 dhe vendimi nr. 17/2016 i Kuvendit, përcaktojnë në mënyrë të qartë dhe të detajuar se subjektet kanë detyrimin ligjor të deklarojnë çdo informacion në lidhje me gjenealitetet e tyre aktuale e të mëparshme, rekordet kriminale brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë (vendime dënimi përfundimtare ose jo, hetime penale jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, masa sigurimi personale, vendime dëbimi, ndalime, arrestime, hetime, etj).
- Në përmbajtje të vendimit të prokurorisë citohet se Z. Artan (Ergi) Nazmi Bitri rezultoi të ketë përdorur gjenealitete të tjera (alias), në shtetin Italian që janë Artan Dokuzi dhe Hasan Berisha, Albbitri Artan, përveç atyre të deklaruara në formular apo të ndryshme nga ato të deklaruara në formular.
- Me gjenealitetet Artan Dokuzi, ka qenë i ndaluar/arrestuar për emigracion klandestin nga Njësia Operative dhe Radiomobile e Karabinierëve të “Compania di Sessa Aurunca (CE)” në datën 09 mars 2005. Liruar në datën 11 mars 2005 nga burgu SMCV, i pajisur me Urdhrin e lëshuar nga Kuestori i Caserta-s për të lënë territorin kombëtar.
- Me gjenealitetet Berisha Hasan me datën 25.03.2002, u shoqërua nga Komisariati i Policisë së Shtetit të Aversas për në Bari për tu dëbuar me ekspuls.
- Me gjenealitetet Albbitri Artan, më 17 Nëntor 2001, është kontrolluar nga Njësia Operative Radiomobile e Bologna-s, dhe nuk ka rezultuar në bazën e të dhënave të SDI.

Nga dokumentacioni i përcjellë, konkludohet se, subjekti nuk ka deklaruar gjenealitete të tjera të mëparshme të përdorura prej tij, gjë që bie ndesh me pikën 3, shkronja “ç”, të Kreut III të Vendimit nr. 17/2016, të Kuvendit parashikohet se: “...pasqyrimi i të dhënave të pavërteta, të paplota dhe të pasakta në të, passjell përjashtimin e menjëhershëm dhe në çdo kohë nga kandidimi/zgjedhja/emërimi apo nga funksioni publik”.

Subjektet mbajnë përgjegjësinë e plotë dhe janë të vetëdijshëm për pasojat ligjore në rast të deklarimeve të pavërteta, të paplota dhe të pasakta, në lidhje me të kaluarën e tyre.

Z. Artan (Ergi) Nazmi Bitri nuk ka deklaruar në Formularin e Vetëdeklarimit gjenealitete të tjera të përdorura prej tij, që sipas rezultatit të verifikimit të Prokurorit të Përgjithshëm janë **Artan Dokuzi, Hasan Berisha dhe Albbitri Artan.**

Në këto kushte, kandidati për deputet ka paraqitur rrethana të paplota, në formularin e vetëdeklarimit, depozituar ne Komisionin Qendror të Zgjedhjeve. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, referuar gjetjeve të Prokurorit të Përgjithshëm vlerëson se mosdeklarimi i gjenealiteteve

të tjera, arrestimit të tij dhe fshehja e tyre, ka qenë me qëllim, për të penguar institucionet e ngarkuara nga ligji nr. 138/2015 për të kryer verifikim të plotë dhe të gjithanshëm, duke qenë se në momentin e plotësimit dhe të dorëzimit të formularit të vetëdeklarimit në KQZ ai ka qenë në dijeni të këtyre fakteve.

Rezoluta e Kuvendit të Shqipërisë “Për vlerësimin e veprimitarisë së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për vitin 2016”. Shprehet se : “.....*Qëllimi i ligjit nr.138/2015, është të garantojë besimin e publikut në funksionimin e organeve të zgjedhura shtetërore, të institucioneve të pavarura dhe atyre të krijuara me ligj, si dhe të administratës publike, nëpërmjet pengimit të zgjedhjes ose emërimit në to apo largimit nga funksioni publik i atyre personave, për të cilët ekzistojnë shkaqet ligjore për të mos u kandiduar, për t’u zgjedhur, apo emëruar, por jo të personave që, për një arsye që nuk lidhet me fshehjen e qëllimshme, kanë referuar të dhëna të ndryshme apo të paplota në raport me të dhënat e gjendura ne regjistrat.)*

Në kuptim të rezolutës së Kuvendit vetëm nëse fshehja e të dhënave është e paqëllimshme, subjekti deklarues nuk është në kushtet për ndalimin e zgjedhjes ose emërimit, apo largimit nga funksioni publik. Në zbatim të ligjit nr.138/2015, Vendimit nr. 17/2016, të Kuvendit të Shqipërisë, dhe informacionit të ardhur nga Prokurori i Përgjithshëm, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve krijon bindjen se kandidati për deputet ka shkelur dispozitat ligjore dhe frymën me të cilën funksionon ligji nr. 138/2015. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, vlerëson se kandidati për deputet, z. Artan (Ergi) Nazmi Bitri, referuar pikës 3, shkronjës “ç”, Kreut III të vendimit të Kuvendit nr. 17/2016, është në kushtet për ndalimin e zgjedhjes ose emërimit në funksion publik.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve me vendimin nr. 408, datë 23.06.2021 miratoi shpërndarjen e mandateve midis subjekteve zgjedhore, përcaktimin e kandidatëve fitues si dhe rirenditjen e kandidatëve, në zonën zgjedhore qarku Durrës për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25.04.2021. Partia Socialiste e Shqipërisë ka fituar 8 (tetë) mandate dhe z. Artan (Ergi) Nazmi Bitri, kandidat i listës shumëmemërore të Partisë Socialiste të Shqipërisë në zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 Prill 2021, qarku Durrës, nuk ka marrë mandatin e deputetit. Duke qenë se subjekti, Partia Socialiste e Shqipërisë, ka marrë 8 mandate në Qarkun Durrës, kandidati z. Artan (Ergi) Bitri, i rirenditur në listë me numrin rendor 14 (katërmbëdhjetë), potencialisht mund të përfitojë mandatin e deputetit për këtë legjislaturë.

Bazuar në nenin 10, pika 1, shkronja “ç”, të ligjit nr. 138/2015, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, brenda kompetencave të veta, “...shpall pavlefshmërinë e mandatit kur kushtet e moskandidimit dhe moszgjedhshmërisë verifikohen pas shpalljes së rezultatit të zgjedhjeve, në përputhje me Kodin Zgjedhor dhe para fillimit të ushtrimit të mandatit nga personi i shpallur i zgjedhur në kundërshtim me këtë nen, si dhe shpall mandatin, në përputhje me Kodin Zgjedhor...”;

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 19, pikat 1, shkronja “n” e 2 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, ligjin nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, pika 3 shkronja “ç” të Kreut III, të vendimit nr. 17/2016, të Kuvendit, “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, neni 190 i Kodit Penal.



V E N D O S:

1. Konstatimin se z. Artan (Ergi) Nazmi Bitri, kandidat për deputet i subjektit zgjedhor, Partia Socialiste e Shqipërisë, Qarku Durrës, përfshihet në kushtet e ndalimit për të ushtruar funksionin publik të deputetit.
2. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga hyrja e tij në fuqi.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI



Data: 13 Shtator 2022

Nr. 190

Për shqyrtimin e rezultatit të verifikimit të Prokurorit të Përgjithshëm për subjektin vetëdeklarues z. Artan (Ergi) Nazmi Bitri, kandidat për deputet i propozuar nga Partia Socialiste e Shqipërisë, qarku Durrës, në zbatim të ligjit nr. 138/2015